



### Firmoset memorandumit i bashkëpunimit për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore



Ministri i Shtetit për Diasporën, së bashku me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Shoqatën për Autonominë Vendore kanë firmosur një memorandum bashkëpunimi për bashkërendimin e punës me qëllim ngritjen e strukturës administrative pranë bashkive, për diasporën dhe migracionin sipas parashikimeve të nenit 29/1 të ligjit Nr. 38/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Krijimi i strukturave administrative synon mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe forcimin e marrëdhënieve me anëtarët e Diasporës shqiptare, të cilët kanë vendlindjen ose origjinën nga territori që ato mbulojnë. Organizimi i strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në njësitë e qeverisjes vendore do të kryhet sipas vlerësimit të numrit të banorëve të tyre, në nivel drejtorie, sektori dhe zyre. Ministri i Shtetit për Diasporën nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës siguron pjesëmarrjen e përfaqësuesve të strukturave administrative për diasporën dhe migracionin të bashkive në forumet apo strukturat konsultuese referuar çështjeve të diasporës.


### Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

### Miratohet vendimi për një shtesë në vendimin nr.780, datë 6.11.2019, të këshillit të ministrave, "Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi"

Me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 445, datë 03.06.2020 "Për një shtesë në Vendimin Nr.780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Caktimin e Oficerëve Koordinues për Çështjet e Diasporës Shqiptare në Konsullatat Shqiptare në Itali dhe Greqi". Sipas këtij vendimi, për vitin 2020, efektet financiare, për zbatimin e tij, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Fushat e veprimit të oficerëve koordinues përfshijnë zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin shqiptar në vendet pritëse, identifikimin e nevojave për arsimimin dhe komunikimin me mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqiptare, nxitjen dhe organizimin e bizneseve shqiptare në vendin pritës si dhe identifikimin dhe asistimin e shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës.



### Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

### Këshilli Koordinues i Diasporës zhvillon mbledhjen e dytë zyrtare online



Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan mbledhjen e dytë zyrtare online. Në mbledhje morën pjesë ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, dhe Drejtorja Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi. Që prej krijimit të Këshillit, anëtarët e tij kanë bashkëpunuar dhe janë angazhuar vazhdimisht për çështjet që kanë të bëjnë me përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të larguar nga vendlindja dhe forcimin e marrëdhënieve të tyre me Shqipërinë. Sipas rendit të ditës, diskutimi u hap nga Kryetari i KKD-së, z. Mark Gjonaj, për të vijuar më tej me një fjalë përshëndetëse nga ministri Majko, i cili theksoi rëndësinë e kësaj strukture përfaqësuese, me anëtarët nga Kanadaja në Australi. Ndër çështjet kryesore të diskutimit ishin raportimi i grupeve të punës që mbulojnë çështjet e medias dhe komunikimit, edukimit dhe kulturës, ekonomisë dhe Kuvendit Mbarëkombëtar të Diasporës 2021, dhe ecuria e punës mbi garantimin e të Drejtës së Votës për Diasporën. Së fundi, anëtarët vendosën për takimin e tretë zyrtar të Këshillit, i cili do të organizohet në datën 30 gusht 2020.

### "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

### Qendra e Botimeve për Diasporën, mbledhje online me mësuesit shqiptarë në Kanada, Turqi dhe Spanjë



Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi mbledhjet online me përfaqësues të shkollave dhe mësuesve të gjuhës shqipe në Kanada, Turqi dhe Spanjë. Takimet shërbyen për një njohje më të mirë të problematikës së mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë dhe për bashkërendimin e punës për të ndihmuar procesin e mësimdhënies. Ndër të tjera u diskutua mbi mënyrën e organizimit të mësimin të gjuhës shqipe në Kanada, Turqi dhe Spanjë e në shkolla të veçanta, mbi hartimin e teksteve të përshtatshme për mësimdhënien në Diasporë, mbi ndihmesën e platformave dhe materialeve didaktike online për mësimin e gjuhës shqipe, nevojën e ngritjes së një forumi online të mësuesve të diasporës, nevojën për promovimin e praktikave të mira dhe të suksesshme të mësuesve për shkëmbimin e përvojave të ndërsjellta, për një vëmendje më të madhe për njohjen e problematikave dhe plotësimin e kërkesave të mësuesve të Diasporës etj. Mësuesit përshëndetën nisimën e Qendrës së Botimeve për Diasporën për organizimin e takimeve online dhe në veçanti punën e bërë deri më tani për të ndihmuar mësimdhënien në Diasporë. Mbledhjet do të vijojnë dhe me përfaqësuesit dhe drejtuesit e lidhjeve të mësuesve në vendet e tjera.

### KKD / Mark Gjonaj dhe organizata "Motrat Qiriazi" ndihma në komunitet



Organizata e Grave Shqiptaro-Amerikane "Motrat Qiriazi", në bashkëpunim me kryetarin e Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Mark Gjonaj, organizuan një drekë, në shenjë falenderimi, për personelin e "Providence Rest Nursing Home" në New York. Nëpërmjet një publikimi në rrjetet sociale bëhet e ditur se: "Si pjesë e përpjekjeve për të mbështetur komunitetin në këto ditë të vështira, organizata "Motrat Qiriazi", në bashkëpunim me anëtarin e Këshillit Mark Gjonaj, dhuruan një drekë falas në shenjë vlerësim të punës në stafin "Providence Rest Nursing Home". Falënderojmë Motrën Selene dhe të gjithë njerëzit në Providence Rest për mbrojtjen e të moshuarve gjatë periudhës së pandemisë. Kjo shtëpi ka mbi 200 punonjës".

### Federata e Shoqatave Arbëreshe apel për mbledhjen e dokumenteve për QSPA-në



Drejtuuesi i Federatës së Shoqatave Arbëreshe (Federazion Associazioni Arbëreshe), studiuesi Damiano Guagliardi, në një status publik, u drejtohet me një apel të gjithë bashkëqytetarëve të tij arbëreshë në Itali, por edhe të tjerëve të interesuar, për të mbledhur libra dhe fonde dokumentare për QSPA-në. Duke vlerësuar nevojat që mund të ketë një qendër e re studimore në ndërtimin dhe pasurimit e fondit të saj arkivor, në këtë thirrje u bëhet ftesë sidomos autorëve arbëreshë dhe të tjerëve që posedojnë botime e dokumente të 40 viteve të fundit, të publikuara kryesisht në Itali, të cilat mundet të mos jenë bërë të njohura në Shqipëri, por edhe materiale të tjera që do të ndihmojnë në njohjen e studimin e arbëreshëve, të kulturës dhe mënyrës së tyre të jetesës, gjatë historisë por edhe sot.

### KKD / Lazim Destani bashkon sipërmarrësit e Diasporës në ndihmë të vendlindjes

Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Lazim Destani sërisht ka ndërmarrë një nismë që i vjen në ndihmë vendlindje. Së bashku me sipërmarrës të tjerë shqiptarë ai ka siguruar 12 mijë teste të analizave për diagnostikimin e koronavirusit të cilat janë dhuruar në Kosovë. Filantropi dhe Presidenti kompanisë "Ecolog International" Lazim Destani, pronari i agjencisë "EuroKoha" Remzi Ejupi dhe Nazmi Viqa kanë arritur që të sigurojnë një sasi jo të pakët testesh në këtë periudhë të pandemisë globale Covid-19. Testet e dhuruara do të jenë padyshim një kontribut për shqiptarët e Kosovës, por edhe një formë e veçantë falenderimi për pjesëtarët e personelit mjekësor të cilët kanë dhënë dhe japin një kontribut të jashtëzakonshëm për parandalimin dhe mjekimin e Covid-19.



Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni:

[www.diasporashqiptare.al](http://www.diasporashqiptare.al)